



POLICIA E KOSOVËS

PLANI PËR INTEGRITET

2024 – 2026



 192

 info@kosovopoliice.com

 www.kosovopoliice.com

PLANI PËR INTEGRITET

PËRMBAJTJA

03

Deklarata e Integritetit

04

Hyrja

05

Qëllimi

06

Përmbajtja e Planit të Integritetit

06

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

10

Metoda e vlerësimit të rrezikut

11

Monitorimit i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

11

Fushat e rrezikut

11

Fushat e përgjithshme të Rrezikut

12

Fushat specifike të rrezikut

Deklarata e Integritetit



Kolonel Gazmend HOXHA

Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Republikës së Kosovës

Integriteti në organizatën policore nënkupton se puna policore udhëhiqet nga një numër vlerash etike të përcaktuara qartë të tilla si: objektiviteti, paanshmëria, profesionalizmi, respekti ndaj gjinisë dhe shumëllojshmërisë, drejtësia, barazia, ndershmëria, llogaridhënia, shumëllojshmëria, respekti për të drejtat e njeriut.

Integriteti është të sjellurit vazhdimisht në përputhje me vlerat etike dhe për këtë, integriteti, si në aspektin individual ashtu edhe në atë institucional, është i rëndësishëm.

Integriteti në nivelin organizativ është tregues se organizata është ndërtuar dhe vepron në përputhje me vlerat etike. Në nivel individual, integriteti nënkupton se individët i përmbahen parimit të integritetit dhe sjelljet e tyre janë në përputhje me vlerat etike të përcaktuara nga organizata.

Integriteti në organizatën policore nënkupton se puna policore udhëhiqet nga një numër vlerash etike të përcaktuara qartë të tilla si: objektiviteti, paanshmëria, profesionalizmi, respekti ndaj gjinisë dhe shumëllojshmërisë, drejtësia, barazia, ndershmëria, llogaridhënia, shumëllojshmëria, respekti për të drejtat e njeriut.

Integriteti duhet të nxitet nga organizata e Policisë në të gjitha nivelet e saj.

Policia është institucion që ka pozitë dhe rol specifik në një shoqëri demokratike, gjë që e bën integritetin edhe më të rëndësishëm për të.

Në mënyrë që t'i përgjigjet besimit të qytetarëve, Policia i përmbahet kodit të etikës dhe demonstroi profesionalizëm dhe integritet të lartë. Bazuar në hulumtimet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, Policia e Kosovës është një ndër institucionet më të besueshme në vend dhe ky vlerësim e bën edhe më përgjegjëse, që t'i avancojë në nivelin më të lartë standardet e punës në politikën kundër dukurive negative dhe dukurive tjera jo etike.

Me krijimin e sektorit të integritetit me strukturë organizative të Policisë dhe zbatimin e këtij plani, Policia e Kosovës vazhdon të tregojë përkushtimin për ngritjen dhe avancimin e integritetit brenda organizatës dhe të jetë shembull i mirë për të tjerët.

Hyrja

Në pajtim me nenin 25 Ligjit nr.08/1-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në përputhje me “Metodologjinë e Planeve të Integritetit” të cilat obligojnë të gjitha institucionet të hartojnë dhe miratojnë planet e integritetit, Policia e Kosovës ka hartuar dhe miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024 -2026.

Plani i integritetit është një dokument i brendshëm tre (3) vjeçar dhe përditësohen çdo vit. Është një proces i dokumentuar për të vlerësuar nivelin e cënueshmerisë së integritetit brenda Institucion dhe që ofron masa për menaxhimin e integritetit për të arritur objektivat e integritetit të institucion.

Plani rithekson përkushtimin e Policisë së Kosovës për të shtuar dhe fuqizuar kontrollet ekzistuese operative në të gjitha aktivitetet brenda fushëveprimit të saj.

Plani përshkruan masat e bazuara në rrezik për arritjen e objektivave të Policisë së Kosovës dhe forcimin e sundimit të ligjit, si dhe vlerat dhe standardet profesionale.

Ky plan konsiderohet pjesë e rëndësishme e proceseve të përgjithshme të planifikimit të lidhura me planin strategjik për zhvillim institucional, i cili shton aspektin e menaxhimit të rrezikut. Në nivel më të gjerë, ai plotëson zbatimin efektiv të Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit të Policisë. Me zbatimin e këtij plani të integritetit, Policia e Kosovës është në pozitë më të mirë për të siguruar efikasitetin, efektivitetin, transparencën dhe etikën e saj.

Qëllimi

Qëllimi i planit për fuqizimin e integritetit në Policinë e Kosovës është që të ketë:

- Sistem efektiv i menaxhimit të integritetit në institucion, përmes sigurimit të menaxhimit të rrezikut të integritetit në mbarë organizatën, me fokus strategjik në fushat me rrezik të lartë; drejtpeshimin mes formave pro aktive dhe reaktive të menaxhimit të rrezikut të integritetit; reduktimin/eliminimin e mundësive për korrupsion dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së përgjithshme ndaj korrupsionit;
- Rezistencë institucionale ndaj cenimeve të integritetit duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteteve të të gjithë personelit për parandalimin efektiv të rreziqeve ndaj integritetit dhe zbulimin e cenueshmërive, ngritjen e vetëdijes në të gjitha nivelet dhe funksionet, inkurajimin e përkushtimit kolektiv dhe bashkëpronësisë në menaxhimin e rrezikut ndaj integritetit;
- Llogaridhënie publike dhe transparencë përmes përmirësimit të kornizës së besimit me aktorët e jashtëm dhe të brendshëm, dhe për t'iu përgjigjur kërkesave dhe pritshmërisë të tyre për sa i përket performancës së integritetit të Policisë së Kosovës.

Objektivat

Përmes Planit të Integritetit synohet:

- Rritja e mundësive që institucioni të arrijë objektivat e menaxhimit të integritetit;
- Identifikimi i rreziqeve dhe masave për zvogëlimin e rreziqeve;
- Përmirësimin e kontroleve ndaj rreziqeve të identifikuar;
- Mbajtjen e një sistemi për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat dhe standardet ligjore dhe procedurale;
- Rritjen e besimit të stafit dhe palëve të jashtme të interesit në përkushtimin për integritet që demonstron nga institucioni.

Përmbajtja e Planit të Integritetit

Plani i integritetit përmban elementet e mëposhtëm:

- Një vetëvlerësim të ekspozimit të institucionit ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit;
- Informacion për fushëveprimin e institucionit;
- Llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit;
- Masat ekzistuese të kontrollit;
- Masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe afatet për zbatimin e tyre;
- Informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e hartimit dhe zbatimin të planit të integritetit;
- Të dhëna të tjera, në përputhje me metodologjinë për hartimin e planit të integritetit.

Procesi i zhvillimit të Planit të Integritetit

Zhvillimi i Planit të Integritetit përbëhet prej disa faza si në vijim:

- **Faza e parë:** Drejtori i përgjithshëm i Policisë ka marrë vendim për emërimin e koordinatorit dhe grupit punues për hartimin e Planit të Integritetit.

Me datën 19.09.2023, grupi punues prej tetë anëtareve (një kryesues dhe shtatë anëtarë) kanë pranuar vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së, Kolonel Gazmend HOXHA rreth hartimit të Planit të Integritetit 2024-2026.

Me datën 23.10.2023 grupi punues përmes korrespondencës së parë elektronike është dakorduar që me datën 25/10/2023 të mbaj takimin e parë informues si dhe orientues rreth fillimit të përgatitjes së planit të integritetit. Po ashtu në këtë korrespondencë kryesuesja e grupit punues ka kërkuar që gjatë takimit të parë t'i referohemi planit paraprak të integritetit me qëllim të orientimit me pragmatik rreth përpilimit të planit të radhës si dhe vendimit për miratimin e metodologjisë të lëshuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Me datën 25/10/2023 është mbajtur takimi i parë mes grupit punues ku janë trajtuar këto çështje:

- Dakordimi për përgatitjen e hulumtimit brenda PK-së si dhe gjetjen e mundësisë së realizimit të hulumtimit në formën online ;
- Të fillohet me përgatitje të mostrës për përpilim të pyetësorëve dhe deri me 31 Tetor 2023 pyetësori të jetë i gatshëm;
- Pas finalizimit të pyetësorëve të fillohet menjëherë me përgatitje të narrativit të dokumentit;
- Grupi punues ka shqyrtuar kornizën ligjore (rregulloret, udhëzimet administrative, planet, kontrollin e brendshëm të auditimit, sistematizimin dhe përshkrimin e vendeve të punës, si dhe burime të tjera informacioni për fushat dhe proceset e punës);

- Nga grupi punues është dërguar kërkesa tek drejtori i teknologjisë informative në lidhje me mundësinë e përkrahjes në realizim të hulumtimit në formën elektronike.

Me 26/10/2023 nga Sektori i Integritetit të PK-se kemi pranuar modelet (mostrën) e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit lidhur me hartimin e planit të integritetit për PK-në.

- **Faza e dytë:** Me datën 27/10/2023 nga anëtarët e grupit kemi pranuar një mostër të një pyetësoi, ku dhe jemi dakorduar që deri me 03/11/2023 të analizohet, përpunohet dhe përcaktohem secili nga këndi personal/profesional dhe në takimin e radhës të përpunohet drejtpërdrejt pyetësoi nga tërë anëtarët e grupit punues.

Nga data 27/10/2023 deri me datën 03/11/2023 nga të gjithë anëtarët e grupit punues kemi pranuar feedback-un (përgjigjen kthyesë) dhe propozime konkrete rreth pyetjeve të përfshira në mostrën e parë të pyetësoit të cilat jemi dakorduar që t'i shtjellojmë të gjitha një nga një gjatë takimit të radhës.

Me datën 06/11/2023 është mbajtur takimi i radhës me grupin punues ku është shqyrtuar, punuar, përpunuar pyetësoi në fjalë.

Me datën 07/11/2023 është finalizuar pyetësoi me të gjitha propozimet/sugjerimet e dhëna nga grupi punues.

Me datën 08/11/2023 nga grupi punues është dërguar pyetësoi në fjalë te drejtori i teknologjisë informative, ku dhe u është kërkuar që të punohet në formën elektronike për të na e lehtësuar procesin e hulumtimit.

Me datën 09/10/2023 nga zyrtari i teknologjisë të PK-së kemi pranuar shkresën se Forma elektronike e pyetësoit është e gatshme, ku njëkohësisht kemi pranuar edhe link-un për të. Po ashtu në shkresën në fjalë kemi pranuar sqarimet e dhëna për pyetësoit në fjalë.

Me datën 10/11/2023 grupi punues ka kontaktuar me zyrtarin e IT-së ku dhe jemi dakorduar që të mbahet një takim mes anëtarëve të grupit dhe zyrtarit të IT-së me qëllim të plotësimit të disa detajeve të pyetësoit.

Me datën 13/11/2023 është mbajtur takimi mes zyrtarit të IT-së dhe anëtarëve të grupit punues ku janë dhënë disa propozime për t'u bërë disa plotësime teknike në pyetësoin në fjalë.

Me datën 15/11/2023 pasi që pyetësoi është finalizuar edhe nga aspekti teknik nga IT-ja, i njëjti është përcjellë tek Drejtorja e Personelit për t'u përkthyer në gjuhën serbe.

Me datën 21/11/2023 nga drejtorja përkatëse kemi pranuar pyetësoin e përkthyer në gjuhën serbe.

Me datën 21/11/2023 pyetësoi në gjuhën serbe është përcjellë te zyrtari i IT-së i cili njëkohësisht është njoftuar se brenda pak ditësh do t'i përcillen edhe adresat elektronike për shpërndarjen e pyetësoit të fokus grupet.

Me 22/11/2023 anëtarët e grupit punues janë takuar me zyrtarin e IT-së për të definuar dhe rishikuar edhe një herë dy versionet e pyetësoit në formën elektronike

Me 27/11/2023 te zyrtari i IT-së nga grupi punues janë përcjellë të gjitha adresat elektronike të fokus grupit ku dhe është vlerësuar të dërgohet pyetësoi.

Me 27/11/2023 është përcjellë pyetësoi elektronik te të gjithë personat e identifikuar si

relevant për t'iu përgjigjur pyetësorit. Fokus grup i hulumtimit kanë qenë eprorët/zyrtarët policorë dhe punonjësit civil nga të gjitha departamentet e PK-së, si dhe nga Zyra e Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm. Përveç përcjelljes së pyetësorit, po ashtu është përcjellë edhe udhëzimi i plotësimit të pyetësorit si dhe data e fundit e përcjelljes së pyetësorëve të plotësuar nga të anketuarit.

Me datën 29/11/2023 nga grupi punues është dërguar shkresë elektronike te të gjithë drejtorët e departamenteve që t'u kërkohet të përcjellin mesazhin te të gjithë vartësitë e tyre duke specifikuar rëndësinë e këtij pyetësori dhe përgjegjshmërinë në plotësim të pyetësorit.

Me datën 01/12/2023 nga zyrtari i IT-së jemi njoftuar rreth numrit të pyetësorëve të pranuar nga të anketuarit e që rezultonte 71%, ku në këtë rast si grup jemi dakorduar që të përcjellim edhe një herë pyetësorin dhe të japim edhe disa dite afat kohor për të dorëzuar pyetësorët e plotësuar.

Me datën 05/12/2023 është përcjellë është një herë pyetësori në fjalë, ku dhe janë dhënë sqarime shtesë rreth afatit dhe rëndësisë së plotësimit të pyetësorit.

Me datën 07/12/2023 nga anëtarët e grupit punues është punuar drafti i parë i narrativit të dokumentit dhe jemi dakorduar që të dërgojmë komentet/sugjerimet/propozimet përkatëse.

- **Faza e tretë:** Grupi punues ka pranuar pyetësorin gjithëpërfshirës, me qëllim të përpunimit të sondazhit të vetëvlerësimit. Hulumtimi është realizuar në mënyrë elektronike, me gjithsejtë 278 respondentë nga të gjitha nivelet e organizimit strukturor të Policisë së Kosovës.

Me datën 18/12/2023 nga zyrtari i IT-së kemi pranuar përgjigjet e pyetësorit elektronik të përpunuar dhe vendosur në dokument PDF, si dhe na është përcjellë link-u i pyetësorëve të plotësuar.

Me datën 18/12/2023 pyetësori i përpunuar me rezultatet e dala nga hulumtimi është përcjellë te grupi punues ku dhe është kërkuar që secili nga fusha a tij/saj të analizojë rezultatin e pyetësorit dhe të identifikojë rreziqet e përgjithshme dhe ato specifike dhe të dërgohen në grup jo më vonë se më datën 22/12/2023.

Me datën 22/12/2023 nga anëtarët e grupit punues janë dërguar rreziqet e identifikuar si dhe plotësimi i narrativit të dokumentit në disa pika.

Me datën 09/01/2024 grupi punues është takuar për të punuar intensivisht në përcaktim dhe vendosje të rreziqeve të përgjithshme, atyre specifike të identifikuar nga hulumtimi si dhe aktiviteteteve të cilat janë vlerësuar si të domosdoshme, nevojshme, matshme dhe objektive.

Me 11/01/2024 grupi punues është dakorduar që të bëhet edhe një rishikim final te fushat e përgjithshme dhe ato specifike të rrezikut.

Me 15/01/2024 grupi punues ka rishikuar edhe një herë në tërësi planin e integritetit edhe pjesën e narrativit dhe rreziqeve të identifikuar, ku nga anëtarët e grupit janë përcjellë disa propozime shtesë për t'u vendosur te pjesa e narrativit.

Mbi bazën e rezultatit të pyetësorit, janë përcaktuar katër (4) fushat e rrezikut të përgjithshëm dhe identifikuar pesëmbëdhjetë (15) fusha të rreziqeve specifike.

Po ashtu bazuar në rreziqet e identifikuara nga grupi punues është punuar plani i veprimit më 27 aktivitetet nga fushat e rreziqeve të përgjithshëm dhe 61 aktivitete nga fushat e rreziqeve specifike që duhet të realizohen në mënyrë që të parandalohen apo shmangen rreziqet që cenojnë integritetin e organizatës.

Përmbledhje: Gjatë fazave të hartimit të Planit të Integritet nga grupi punues janë:

- mbajtur tri takime me të gjithë anëtarët e grupit, takime të formatit të punëtorisë;
- Mbajtur katër takime të ndara me disa anëtarë të caktuar të grupit punues të cilët kanë qenë të deleguar për punim të fushave të caktuara në hartimin e dokumentit;
- Mbajtur dy takime mes anëtarëve të grupit dhe zyrtarit të IT-së;
- Shkëmbyer 43 shkresa mes grupit punues.

Metoda e vlerësimit të rrezikut

Metoda e Vlerësimit të rreziqeve përcakton probabilitetin e shfaqjes dhe pasojave të cenimit të integritetit dhe formave të tjera të sjelljes së paligjshme ose jo etike.

Përmes vlerësimit të rrezikut përcaktohet mundësia e ndodhjes dhe niveli i pasojës, i cili mund të jetë: i ulët/i mesëm/i lartë. Niveli përfundimtar i rrezikut përcaktohet sipas matricës së rrezikut, në formën e një kombinimi mes mundësisë dhe pasojës.

Figura 1 . Matrica e vlerësimit të rrezikut

Pasoja /Ndikimi	Madhor	10																		
		9																		
		8																		
	Mesatar	7																		
		6																		
		5																		
		4																		
	Vogël	3																		
		2																		
		1	2	3	4	5	6	7	8	9	10									
Intenziteti i rrezikut (gjasat X ndikimi)		Ulët			Mesatar				Lartë											
		Probabiliteti/Gjasat																		

Intenziteti i rrezikut fitohet duke shumëzuar probabilitetin/gjasën me pasojën/ndikimin, duke përdorur matricën e rrezikut, "ndikimi (1-10) x pasoja (1-10)", treguar në figurën si më lartë.

Vlerësimi i përgjithshëm i rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera të cenimit të integritetit, vlerësohet nga 1 në 100, si në tabelën e më poshtme:

Ulët	Mesatar	Lartë
1 - 15 pikë	16 - 48	49 - 100

■ - Rreziku me intensitet të ulët - mundësia e ndodhjes së korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është shumë e vogël për shkak të masave ekzistuese të kontrollit.

■ - Rreziku me intensitet të mesëm - ndodhja e korrupsionit ose formave tjera të cenimit të integritetit është e mundur, por masat e kontrollit menaxhojnë këtë rrezik.

■ - Rreziku me intensitet të lartë - korrupsioni ose format e tjera të cenimit të integritetit janë tashmë të pranishëm në këtë proces ose ka të ngjarë të ndodhin.

Monitorimi i zbatimit të Planit të Integritetit dhe raportimi

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në vazhdimësi nga Sektori për Integritet gjegjësisht Zyrtari përgjegjës nga Policia e Kosovës dhe nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit është i rëndësishëm për t'u siguruar se kontrolli i rrezikut të integritetit dhe masat për trajtim janë efektive, si në hartim ashtu edhe në zbatim, dhe se procedurat janë kuptuar, si dhe plani integriteti është ndjekur.

Gjithashtu, monitorimi duhet të përcaktojë nëse masat e përdorura për trajtimin e rreziku kanë prodhuar efektet e planifikuara, kanë zbuluar ndryshimet në kontekstin e jashtëm dhe të brendshëm përfshirë ndryshimet e vetë rrezikut, ndryshime që kërkojnë rishikimin e trajtimit dhe prioriteteve të rrezikut si dhe kanë identifikuar cilat mësim duhen nxjerrë për planifikim në të ardhmen.

Detyrat dhe aktivitetet që rrjedhin nga "Plani për integritet 2024 - 2026" janë obligative (të zbatueshme) për të gjithë komponentët strukturorë dhe organizative në Policinë e Kosovës. Të gjitha departamentet, divizionet, drejtoritë, sektorët dhe njësitet në kuadër të strukturës organizative të PK-së, raportojnë në sektorin për integritet në periudha të rregullta **gjashtë (6)** mujore por edhe në periudha me të afërta kohore nëse një gjë e tillë kërkohet sipas planit për integritet lidhur me zbatimin e veprimeve dhe masave në fuqizimin e integritetit.

Raportimi i rregullt siguron se zbatimi i planit bëhet në përputhje me orarin dhe se rezultatet e planifikuara janë arritur. Gjithashtu, pas hartimit të raportit për zbatimin e planit të integritetit nga zyrtari përgjegjës brenda institucionit, raporti duhet të dërgohet për vlerësim në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit.

Fushat e rrezikut

1. Fushat e përgjithshme të Rrezikut

Fushat e përgjithshme të rrezikut janë:

- Fusha e menaxhimit financiar,
- Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore;
- Fusha e ushtrimit të autorizimeve policore
- Fuqizimi i parimit të objektivitetit, paanshmërisë dhe transparencës.

2. Fushat specifike të rrezikut

Fushat e specifike të rrezikut janë:

- Prokurimi publik;
- Auditimi;
- Menaxhimi i projekteve/kontratave;
- Rekrutimi dhe promovimet;
- Mungesa e trajnimeve në fushën e etikës, integritetit, konfliktit të interesit, parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare;
- Puna dytësore dhe jashtë detyrës zyrtare;
- Inspektimet;
- Fusha e mbikëqyrjes dhe kontrollit të rendit publik;
- Fusha e mbikëqyrjes dhe kontrollit të komunikacionit rrugor;
- Menaxhimi, kontrollimi dhe monitorimi rasteve penale që janë duke u hetuar;
- Kontrollimi dhe mbikëqyrja kufitare si dhe migracioni;
- Parandalimi i konfliktit të interesit;
- Informimi për publikun dhe punonjësit (transparenca);
- Fuqizimi i mekanizmit të sinjalizimit;
- Pranimi dhe deklarimi i dhuratave.

Planit i Integritetit								
Fushat e përgjithshme të rrezikut								
Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin/eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1. Menaxhimi financiar	1.1. Transparenca	Auditimi i brendshëm dhe i jashtëm;	4	9	36	Rritja e Transparencës dhe llogaridhënies;	Departamenti i shërbimeve mbështetëse	Në vazhdimësi
	1.2. Kontrollat dhe inspektimet	Inspektimi i brendshëm dhe i jashtëm;	4	8	32	Auditimet periodike dhe jashtëzakonshme;	Njësia e auditimit e PK-se dhe auditori gjeneral	6 muaj
	1.3. Caktimi i profesionistëve		6	9	54	Hartimi i kriterëve për caktimin e anëtarëve të komisioneve në hartimit e specifikave sipas fushave përkatëse;	Departamenti i shërbimeve mbështetëse; Drejtori i prokurimit dhe menaxheri i projektit.	3 muaj
2. Menaxhimi i burimeve njerëzore	2.1. Sistemimi i personelit sipas strukturës organizative	Inspektimet e jashtëme dhe të brendshme;	3	7	21	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies; Rishikimi i akteve normative;	Departamenti i burimeve njerëzore; Drejtorja e planifikimit strategjik dhe	Në vazhdimësi

					Vlerësimi paraprak i nevojave;	qëshjeve ligjore (DPSQL).	6 muaj 3 muaj
	2.2.Kualiteti i trajnimeve dhe mësimdhënies		5	9	45	Rishikimi dhe plotësimi i programeve mësimore; Akreditimi i programeve mësimore; Avancimi i kapaciteteve të mësimdhënies;	Divizioni i trajnimeve 9 muaj 12 muaj 12 muaj
	2.3.Konflikti i interesit.		5	7	35	Rifreskimi i PSO-ve; Përcaktimi i detyrave që mund të paraqesin konflikt interesi; Rritja e monitorimeve dhe inspektimeve.	Departamenti i burimeve njerëzore; 6 muaj Drejtoria e planifikimit strategjik dhe qeshjeve ligjore (DPSQL); 6 muaj Njësia për punë sekondare dhe jashtë detyrës zyrtare. 3 muaj

3. Fusha e ushtrimit të autorizimeve policore	3.1. Mos përmbushja e autorizimeve policore	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e auditimit; Inspektimet nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).	5	9	45	Ngritja e nivelit të Inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme; Raportimet dhe rekomandimet mbi të gjeturat; Veprimet e ndërmarra.	I tërë Menaxhmenti dhe njësit inspektuese	Në vazhdimësi 6 muaj 6 muaj
	3.2. Paqartësitë mes njësive organizative		3	9	27	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit dhe raportimit nga menaxhmenti; Rishikimi i akteve normative.	I tërë Menaxhmenti dhe njësit inspektuese; Drejtoria e planifikimit strategjik dhe qeshjeve ligjore (DPSQL).	Në vazhdimësi 9 muaj
	3.3. Mungesa e pajisjeve		6	10	60	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit dhe raportimit nga menaxhmenti. Vlerësimi i nevojave.	I tërë Menaxhmenti dhe njësit inspektuese; Departamenti i shërbimeve mbështetëse.	Në vazhdimësi 6 muaj
	3.4. Bashkëpunimi, Komunikimi		5	10	50	Organizimi i takimeve, konferencave;	I tërë Menaxhmenti;	Në vazhdimësi

						Rritja bashkëpunimit dhe komunikimit; Transparenca; Raportimi.	Divizioni i Policimit në Bashkësi; Drejtoria dhe Zyrat për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.	6 muaj
	3.5. Parandalimi i konfliktit të interesit		7	8	56	Hartimi dhe azhurnimi i procedurave dhe akteve normative	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe qeshjeve ligjore (DPSQL); Zyrtari përgjegjës.	6 muaj
4. Fuqizimi i parimit të objektivitetit, paanshmërisë dhe transparencës,	4.1. Komunikimi me publikun dhe punonjësit (transparenca)	Drejtoria për informim dhe marrëdhënie me publikun; Drejtoria e Hetimeve të Brendshme.	3	8	24	Rritja e transparencës në fushën e informimit publik për aktivitetet policore.	Drejtoria dhe Zyrat për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.	Në vazhdimësi
	4.2. Qasja në dokumente zyrtare		3	7	21	Azhurnimi i procedurave dhe akteve normative për qasje në dokumente zyrtare dhe klasifikim e tyre.	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe qeshjeve ligjore (DPSQL); Zyrtaret përgjegjës sipas ligjit.	6 muaj

	4.3. Pranimi dhe trajtimi me kohe i kërkesa dhe ankesave		4	8	32	Rritja e llogaridhënies dhe përgjegjësisë;	I tërë Menaxhmenti; Drejtoria e Hetimeve të Brendshme.	Në vazhdimësi
	4.4. Ankesat që ndërlidhën me etiken, integritetin, konfliktin e interesit, korrupsionin dhe keqpërdorimin e detyrës zyrtare		5	10	50	Trajtimi me prioritet i kësaj kategorie të ankesave; Raportimi.	I tërë Menaxhmenti; Drejtoria e Hetimeve të Brendshme.	Në vazhdimësi 6 muaj

Fushat e veçanta të rrezikut

Regjistrimi i rrezikut			Vlerësimi dhe matja e rrezikut			Veprimi ndaj rrezikut		
Fusha e rrezikut	Përshkrimi i Rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi i rrezikut	Masat e propozuara për zvogëlimin / eliminimin e rreziqeve	Njësia/zyrtari përgjegjës	Afati i realizimit
1. Prokurimi publik;	1.1. Transparenca	Auditimi brendshëm; Auditimi jashtëm;	6	9	54	Rritja e Transparencës; Publikimi i Kontratave sipas legjislacionit në fuqi.	Departamenti i shërbimeve mbështetëse; Drejtori i prokurimit.	Në vazhdimësi
	1.2. Konflikti i interesit		6	10	60	Hartimi dhe azhurnimi i procedurave dhe akteve normative.	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore (DPSQL); Departamenti i shërbimeve mbështetëse.	6 muaj
	1.3. Llogaridhënia, Profesionalizmi		5	10	50	Caktimi i profesionistëve në hartimit e specifikave sipas fushave përkatëse; Raportimi.	Departamenti i shërbimeve mbështetëse; Drejtori i prokurimit.	Në vazhdimësi 6 muaj

2. Auditimi	2.1.Kryerja e auditimit vetëm periodik	Auditimi i brendshëm; Auditimi i jashtëm;	4	7	28	Rritja e auditimeve të jashtëzakonshme; Raportimi dhe rekomandimet nga raportet e auditimit.	Njësia e Auditimit e PK-se dhe auditori gjeneral.	Në vazhdimësi 6 muaj
3. Menaxhimi i projekteve/kontratave	3.1. Inspektimi; Mos njohurit e mjaftueshme	Inspektimi i brendshëm dhe i jashtëm;	4	8	32	Transparenca dhe llogaridhënia; Inspektimet jashtëzakonshme; Caktimi i profesionistëve.	Drejtori i prokurimit dhe menaxheri i projektit/kontratës; Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës.	Në vazhdimësi 6 muaj Në vazhdimësi
4.Rekrutimi dhe promovimet	4.1. Transparenca dhe llogaridhënia	Komisionet mbikëqyrëse dhe inspektimet e jashtësme dhe të brendshme;	3	7	21	Rritja e transparencës dhe llogaridhënies; Aplikimi i sistemit audiovizuel; Rishikimi i akteve normative.	Departamenti i burimeve njerëzore; Drejtoria e planifikimit strategjik dhe qeshjeve ligjore (DPSQL).	Në vazhdimësi 6 muaj

<p>5. Mungesa e trajnimeve në fushën e etikës, integritetit, konfliktit të interesit, parandalimit të korrupsionit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare;</p>	<p>5.1. Mangësitë në kryerjen e detyrës dhe mungesa e profesionalizmit</p>	<p>Inspektimi; Vlerësimi.</p>	<p>5</p>	<p>10</p>	<p>50</p>	<p>Hulumtimet në fushat përkatëse; Hartimi i programeve të reja mësimore; Rishikimi dhe plotësimi i programeve mësimore; Avancimi i kapaciteteve të mësimdhënies; Organizimi i trajnimeve.</p>	<p>Divizioni i trajnimeve</p>	<p>3 muaj 6 muaj 6 muaj 12 muaj 12 muaj</p>
<p>6. Puna dytësore dhe jashtë detyrës zyrtare;</p>	<p>6.1. Keqpërdorimi i detyrës zyrtare</p>	<p>Njësia për punë dytësore dhe jashtë detyrës zyrtare; Mbikëqyrja nga stacionet përgjegjëse.</p>	<p>5</p>	<p>7</p>	<p>35</p>	<p>Rifreskimi i PSO-ve; Përcaktimi i detyrave që mund të paraqesin konflikt interesi; Monitorimi dhe inspektimi nga njësia për punë dytësore dhe jashtë detyrës zyrtare; Raportimi.</p>	<p>Departamenti i burimeve njerëzore Njësia për punë sekondare dhe jashtë detyrës zyrtare.</p>	<p>6 muaj 6 muaj Në vazhdimësi 6 muaj</p>

7. Inspektimet, duke përfshirë ato të rregullta, jashtëzakonshme dhe të çastit;	7.1. Mos përmbushja e autorizimeve policore	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e auditimit; Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).	6	8	48	Ngritja e nivelit të Inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme; Raportimet dhe rekomandimet mbi të gjeturat; Veprimet e ndërmarra.	Menaxhmenti në të gjitha nivelet dhe njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj 6 muaj
	7.2. Tejkalimi i autorizimeve policore		5	10	50	Ngritja e nivelit të Inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme; Raportimet dhe rekomandimet mbi të gjeturat; Veprimet e ndërmarra; Procese të iniciuara.	Menaxhmenti në të gjitha nivelet dhe njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj 6 muaj 12 muaj
	7.3. Mos respektimi i procedurave të punës		5	9	45	Ngritja e nivelit të Inspektimeve të rregullta dhe të jashtëzakonshme;	Menaxhmenti në të gjitha nivelet dhe njësit inspektuese	Në vazhdimësi

						Raportimet dhe rekomandimet mbi të gjeturat; Veprimet e ndërmarra.		6 muaj 6 muaj
8. Fusha e mbikëqyrjes dhe kontrollit të rendit publik.	8.1.Mos përmbushja e autorizimeve policore	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e auditimit;	3	9	27	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i rendit publik; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj
	8.2.Te jkalmi i autorizimeve policore	Inspektorati Policor i Kosovës (IPK-ja).	4	9	36	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i rendit publik; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj
	8.3.Mos respektimi i procedurave të punës		3	9	27	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i rendit publik; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj

9. Fusha e mbikëqyrjes dhe kontrollit komunikacionit rrugor.	9.1.Mos përmbushja e autorizimeve policore	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit Njësia e auditimit Inspektorati Policor i Kosovës (IPK-ja).	5	10	50	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti. Pajisja me mjete inteligjente; Pajisja me kamera trupore;	Departamenti i rendit publik; Divizioni i Trafikut Rrugorë; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj 12 muaj 12 muaj
	9.2. Tejkalimi i autorizimeve policore		6	10	60	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti. Pajisja me mjete inteligjente; Pajisja me kamera trupore.	Departamenti i rendit publik; Divizioni i Trafikut Rrugorë; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj 12 muaj 12 muaj
	9.3.Mos respektimi i procedurave të punës		6	8	48	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i rendit publik; Divizioni i Trafikut Rrugorë; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj

10. Menaxhimi, kontrollimi dhe monitorimi rasteve penale që janë duke u hetuar.	10.1. Trajtimi jo i drejte i rasteve	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e auditimit;	5	10	50	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti; Llogaridhënia.	Departamenti i hetimeve; Departamenti i rendit publik; Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj Në vazhdimësi
	10.2. Ndarja jo meritore e rasteve	Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).	4	10	40	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti; Regjistrimi i ndarjes së rasteve në bazën e të dhënave.	Departamenti i hetimeve; Departamenti i rendit publik; Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj Në vazhdimësi
	10.3. Vonesa në trajtimin e rasteve		4	10	40	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti; Monitorimi i ecuresë së rasteve.	Departamenti i hetimeve; Departamenti i rendit publik; Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj Në vazhdimësi

11. Kontrollimi dhe mbikëqyrja kufitare si dhe migracioni.	11.1.Mos përmbushja e autorizimeve policore	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e	5	9	45	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese	Në vazhdimësi 6 muaj
	11.2. Tejkalmi i autorizimeve policore	Inspektorati Policor i Kosovës (IPK-ja).	5	10	50	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese	Në vazhdimësi 6 muaj
	11.3.Mos respektimi i procedurave të punës.		4	9	36	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti.	Departamenti i Kufirit; Njësit inspektuese.	Në vazhdimësi 6 muaj
12. Parandalimi i konfliktit të interesit.	12.1.Mos raportimi i konfliktit të interesit.	Mbikëqyrja dhe kontrolli nga menaxhmenti; Njësia e inspektimit dhe njësia e auditimit; Inspektorati Policor i Kosovës (IPK).	5	10	50	Fuqizimi i mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit; Raportimit nga menaxhmenti; Hartimi dhe azhurnimi i procedurave dhe akteve normative.	Menaxhmenti në të gjitha nivelet dhe njësit inspektuese; Drejtoria e planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore (DPSQL) Zyrtari përgjegjës	Në vazhdimësi 6 muaj 6 muaj

	12.2. Mungesa e njohurive për konflikt interesi.		7	8	56	Hartimi i planeve mësimore; Trajnimi i personelit.	Divizioni i trajnimeve.	6 muaj 12 muaj
13. Informimi për dhe publikun punonjësit (transparenca).	13.1. Mungesa e informimit/keqkuptimet	Drejtoria për informim dhe marrëdhënie me publikun.	3	8	24	Pasurimi dhe plotësimi me informacione të web faqes së policisë; Organizimi i kampanjave informuese për publikun; Shpërndarja e materialeve (fletushkave) informuese.	Drejtoria dhe Zyrat për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.	Në vazhdimësi 9 muaj 9 muaj
	13.2. Ulja e besueshmërisë.		3	9	27	Rritja e transparencës në fushën e informimit publik.	Drejtoria dhe Zyrat për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.	Në vazhdimësi
	13.3. Komunikimi i varfër brenda organizatës.		3	8	24	Avancimin i komunikimit dhe informimit përmes sistemit elektronik.	Departamenti i shërbimeve mbështetëse.	12 muaj
	13.4. Dokumentet e klasifikuara.		3	10	30	Azhurnimi i procedurave dhe akteve normative për	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe	6 muaj

						klasifikimin e dokumenteve.	çështjeve ligjore (DPSQL); Drejtoria dhe Zyrat për Informim dhe Marrëdhënie me Publikun.	
14. Forcimi i mekanizmit të sinjalizimit.	14.1. Mos njohurit për rendësin e sinjalizimit.	Zyrtarët për sinjalizim.	5	7	35	Azhurnimi i procedurave dhe akteve normative; Trajnimi për rëndësinë e sinjalizimit.	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore (DPSQL); Zyrtarët përgjegjës; Divizioni i trajnimeve.	6 muaj 12 muaj
	14.2. Hezitimi për sinjalizim.		6	7	42	Trajnimi për rëndësinë e sinjalizimit; Raportimi.	Divizioni i trajnimeve; Zyrtarët përgjegjës.	12 muaj 6 muaj
15. Pranimi dhe deklarimi i dhuratave.	15.1. Mos respektimi i akteve normative.	Menaxhmenti.	4	8	32	Azhurnimi i procedurave dhe akteve normative për pranim dhe deklarim të dhuratave.	Drejtoria e planifikimit strategjik dhe çështjeve ligjore (DPSQL); Zyrtarët përgjegjës sipas ligjit.	6 muaj
